

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË – Departamenti për Krime të Rënda, gjyqtari Beqir Kalludra – kryetar i trupit gjykues, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores Mybera Latifi, procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të akuzuarit P.R, nga P, rr. "A", pn., për shkak të veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së në bashkim real me veprën penale të përdorimit të armës nga neni 375 par.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë-Departamenti për Krime të Rënda, PP/I.nr.511/16 dt.21.11.2016, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit fillestar me dt.09.12.2016, në të cilën kanë prezentuar prokurori i shtetit Ibrahim Berisha, i akuzuari dhe mbrojtësi av.R.K, sipas autorizimit, mori dhe të njëjtën ditë shpalli publikisht këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari P.R, i biri i N dhe A, e gjinisë A, i lindur me dt.data e lindjes, në P, rr. "A" pn., ku edhe tani jeton, ka të kryer shkollën e mesme, i martuar, baba i tre fëmijëve, i gjendjes së mesme ekonomike, tregtar, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me nr. *numer personal*

Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse

Pasi më parë ka siguruar dhe deri më dt.10.07.2016, rreth orës 16.33, i pandehuri ka mbajtur në pronësi armën në kundërshtim me nenin 4 par.1 nënpar.1.2 dhe nenin 17 par.1 të Ligjit për Armët të Republikës së Kosovës, për të cilën me ligj kërkohet leja dhe atë një (1) armë të tipit karabinë-pushkë e gjatë me shul një tytëshe me dylbi me nr.serik 5318 dhe një gëzhjojë me mbishkrimin "bazë 11 55", në atë mënyrë që ditën kritike në fshatin H, komuna e P, i pandehuri ka përdorur këtë armë, me të cilën ka shtënë dy herë, njëherë herë duke dashur të gjuaj në shënjestër, papritmas arma kishte shkrepur ndërsa predha e fishekut kishte përfunduar nën gjurin e këmbës së majtë të tij duke ia shpuar gjurin dhe këpucën prej ku predha kishte dalë jashtë, ndërsa herën tjetër kishte shtënë në drejtim të shtëpisë së pabanuar ku predha i ishte kthyer rikoshe duke e gërvishtur në pjesën e abdomenit, ndërsa e njëjta armë më pastaj i është gjetur dhe sekuestruar nga ana e policisë

-me këtë ka kryer veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së në bashkim real me veprën penale të përdorimit të armës nga neni 375 par.1 të KPRK-së,

Prandaj, gjykata konform dispozitave 2, 4, 41,46, 47, 73, 74 dhe 374 par.1 dhe 3 lidhur me nenin 375 të KPRK-së, si dhe nenit 359, 365, 368 dhe 450 dhe 453 të KPPRK-së, e:

G J Y K O N

ME DËNIM ME GJOBË në shumën prej 500 (pesëqind) Euro, të cilin dënim i akuzuari është i obliguar t'a paguaj në afat prej 15 ditësh, pas plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse i akuzuari nuk dëshiron ose nuk mund të paguaj dënimin me gjobë, Gjykata ia zëvendëson dënimin me gjobë në dënim me burgim, duke ua llogaritur 1 (një) ditë burgim, me 20 Euro të gjobës, me kusht që afati i burgimit të mos i tejkalohet 6 muaj.

Detyrohet i akuzuari që t'i paguaj shpenzimet e procedurës penale, aq sa do të jenë sipas llogarisë përfundimtare të kësaj Gjykate, ndërsa shpenzimet në emër të paushallit gjyqësorë, shumën prej 30 (tridhjetë) Euro, brenda afatit prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Të akuzuarit i konfiskohen një armë e tipit karabinë-pushkë e gjatë me shul një tytëshe me dylbi me nr.serik 5318 dhe një gëzhjojë me mbishkrimin "bazë 11 55", si mjet ky me të cilin është kryer vepra penale, dhe të njëjtat të shkatërrohen pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë-Departamenti për Krime të Rënda, ka paraqitur aktakuzë PP/I.nr.511/16 dt.21.11.2016, kundër të akuzuarit P.R, për shkak të veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armës nga neni 374 par.1 të KPRK-së në bashkim real me veprën penale të përdorimit të armës nga neni 375 par.1 të KPRK-së.

Lidhur me këtë çështje penale, Gjykata ka caktuar seancën e shqyrtimit fillestar, me dt.09.12.2016, në të cilën seancë është aprovuar marrëveshja për pranimin e fajësisë e lidhur në mes të mbrojtësit të të akuzuarit dhe prokurorit të shtetit, e nënshkruar edhe nga i akuzuari dhe prokurori i shtetit.

Meqë gjykata e ka pranuar marrëveshjen për pranimin e fajësisë pasi që është bindur paraprakisht se i akuzuari marrëveshjen për pranimin e fajësisë e ka nënshkruar pasi që e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të kryerjes së veprës penale, pranim i cili është bërë vullnetarisht dhe pas konsultimit të mjaftueshëm dhe në prezencën e mbrojtësit, pranim i cili mbështetet në faktet e çështjes dhe provat materiale që përmban aktakuza, dhe se nuk përmban asnjë shkelje ligjore apo gabim faktik, Gjykata vlerësoj se janë përmbushur të gjitha kërkesat ligjore nga neni 248 të KPPRK-së, që të pranohet marrëveshja e të akuzuarit për pranimin e fajësisë për kryerjen e kësaj vepre penale, dhe të njëjtën edhe e ka aprovuar, duke mos administruar asnjë provë lidhur me vërtetësinë e gjendjes faktike.

Ashtu që, bazuar në një gjendje të tillë të pa kontestuar të fakteve, gjykata vërtetoj se në veprimet e të akuzuarit P.R manifestohen të gjitha elementet qenësore të veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së në bashkim real me veprën penale të përdorimit të armës nga neni 375 par.1 të KPRK-së, ashtu që të akuzuarin edhe e shpalli fajtor, dhe ia shqiptoj sanksionin penal përkatës, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Prokurori i shtetit në fund ka deklaruar se meqë i akuzuari e ka pranuar fajësinë, i ka propozuar gjykatës, që të njëjtin ta shpall fajtor dhe t'ia shqiptoj një sanksion penal përkatës, dhe me rastin e vendosjes për llojin dhe lartësinë e sanksionit penal, që t'a marrë parasysht pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, dhe t'a vlerësoi si rrethanë lehtësuese.

Mbrojtësi i të akuzuarit P.R av.R.K ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë rrethanave të propozuara në marrëveshje për shqiptimin e dënimit pra faktit se i akuzuari ka shpreh keqardhje dhe pendim të thellë për veprën e kryer, ka premtuar se në të ardhmen nuk do ti përsëris këto veprime, sjelljen e të akuzuarit pas kryerjes së veprës penale, prezentimi i të njëjtit në polici, prokurori e në gjykatë dhe bashkëpunimi me organet e ndjekjes, se i njëjti është i moshës relativisht të re dhe se i njëjti e ka pranuar fajësinë që në fazën e hetimeve. Andaj bazuar në këto rrethana i ka propozuar gjykatës, që të njëjtit ti shqiptohet një dënim me gjobë.

I akuzuari P.R po ashtu e ka mbështetë në tërësi propozimin edhe të prokurorit të shtetit edhe të mbrojtësit të tij, propozim i cili rezulton nga marrëveshja për pranimin e fajësisë që të njëjtit ti shqiptohet dënimi me gjobë në shumën prej 500 deri në 700 euro, duke i vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese lidhur me shqiptimin e sanksionit penal.

Gjykata me rastin e matjes dhe përcaktimit të lartësisë dhe llojit të sanksionit penal për të akuzuarin, i vlerësoi të gjitha rrethanat relevante rënduese dhe lehtësuese, në kuptim të nenit 74 të KPRK-së, andaj si rrethanë lehtësuese për të akuzuarin mori faktin se, i njëjti e ka pranuar fajësinë në mënyrë shumë të sinqertë, sjellja dhe qëndrimi i tij shumë korrekt në gjykatë, se kjo gjykatë nuk ka të dhëna se i njëjti ka qenë i gjykuar më parë, pendimi i thellë i tij për këtë vepër penale, premtimi i të njëjtit se në të ardhmen nuk do ti përsëris asnjëherë këto veprime, si dhe gjendjen ekonomike, e në mungesë të rrethanave rënduese, të akuzuarit ia shqiptojë sanksionin penal si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, i propozuar edhe në marrëveshje për pranimin e fajësisë, me bindje se një sanksion i tillë penal, është në përputhshmëri të plotë me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të kësaj vepre penale dhe përgjegjësisë penale të të akuzuarit, dhe se dënimi i shqiptuar do të ndikojë në riedukimin, risocializimin dhe parandalimin e të akuzuarit dhe personave tjerë nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, me çka edhe do të arrihet qëllimi i përgjithshëm dhe i veçantë i dënimit konform nenit 41 të KPPK-së.

Vendimi lidhur me shpenzimet e procedurës penale kundër të akuzuarit, do të merret në bazë të llogarisë përfundimtare të kësaj gjykate, ndërkaq shpenzimet në emër të paushallit gjyqësor janë marrë, duke pasur për bazë ndërlikueshmërinë e veprës penale, kohëzgjatjen e zhvillimit të procedurës penale si dhe gjendjen pasurore të të akuzuarit, konform nenit 450 par.3 të KPRK-së.

Vendimi lidhur me konfiskimin e armës dhe mjeteve tjera me të cilat është kryer kjo vepër penale, është marrë konform nenit 374 par.3 të KPRK-së.

Nga arsyet e cekura më lartë, e në pajtim me dispozitat ligjore nga neni 365 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - Departamenti për Krime të Rënda
PKR.nr.706/16, dt.09.12.2016

Procesmbajtësja
Mybera Latifi

Kryetari i trupit gjykues - gjyqtari
Beqir Kalludra

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit në Prishtinë në afat prej 15 ditëve nga dita e marrjes së të njëjtit, e përmes kësaj gjykate.